

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - MALLRA

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje pjesësh dhe mirëmbajtje ashensorësh” për nevojat e Spitalit Rajonal Durrës

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):

42419510-4 (pjesë për ashensorë)

50750000-7 (shërbim për mirëmbajtje)

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,517,000 (dy milion e pesëqind e shtatëmbëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1.Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke vlerësuar

që plotësimi i kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

2.2.Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 39 % e fondit limit të objektit që prokurohet**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr. 7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, është vendosur me qëllim sigurimin e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi, si dhe AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më të vogël se 19% e fondit limit të objektit që prokurohet**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licensë profesionale të vleshme, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore, për kategorinë:

- NS- 3 A “Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Ligjin nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret e procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencën profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Duke vlerësuar që nëpërmjet licencës N.S-3 Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues) konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve transportuese, ashensorë, shkallë të lëvizshme, ngritëse dhe të transportit...Licenca dhe kategoria, e përcaktuar si kriter është në përputhje dhe lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës që do të prokurohet, fondin limit dhe cilësinë e shërbimit, që kërkohet të ofrohet nëpërmjet kësaj marrëveshje kuadër.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar stafin teknik, për realizimin e shërbimeve objekt prokurimi, sipas profileve të mëposhtme:

- a) 1 (një) Drejtues Teknik inxhinier mekanik, i përfshirë në licencën profesionale të ofertuesit
- b) 1 (një) punonjës elektrikist
- c) 1 (një) punonjës mekanik
- d) 1(një) teknik për kryerjen e kontrolleve në ashensorë

Për punonjësin në pikën a, duhet të paraqitet:

- Diplomë përkatëse
- kontratë pune të vlefshme gjatë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër

Për punonjësin në pikën b, c, d, duhet të paraqitet:

- kontratë pune të vlefshme gjatë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
- dëshmi aftësie profesionale (të vlefshme), sipas Ligjit Nr.15/2017, ”Mbi arsimin dhe formimin profesional”, i ndryshuar

Shenim Ky Kriter konsiderohet i përbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike dhe frekuencës së zbatimit hartuar nga AK, për llogari të së cilit OBP zhvillon procedurën e prokurimit.

Drejtues Teknik nevojitet për organizimin, drejtimin, ndarjen dhe mbikëqyrjen e punëve, si dhe përgjigjet për zbatimin e të gjitha detyrave dhe fazave të shërbimit, në përputhje me specifikimet teknike, rregullat dhe standartet ligjore të zbatueshme në fuqi.

Për shkak të natyrës teknike të objektit të prokurimit, ku ashensorët janë sisteme të ndërlikuara që përbëhen nga motorrë elektrikë, sisteme mekanike ngritëse, komponentë frenues etj., të ndërhyrjeve që kërkojnë njohuri të avancuara mbi sistemet mekanike, si dhe të nevojës për mbikëqyrje të përgjegjshme dhe të certifikuar, drejtuesi Teknik vlerësohet të jetë inxhinier mekanik, duke siguruar AK se mbikëqyrja e shërbimeve të mirëmbajtjes, ndërhyrjeve si dhe vlerësimi i kërkesave teknike të AK, verifikimi i cilësisë së shërbimeve do të jetë brenda standarteve të zbatueshme në fuqi. Duke qenë se objekti i prokurimit përmban edhe furnizim vendosjen e pjesëve të defektuara apo të nevojshme për t’u ndërruar/riparuar, inxhinieri mekanik është i aftë të vlerësojë përputhshmërinë e pjesës së re, analizon ndikimin në sistemin ekzistues dhe për të bërë balancimin termik dhe dinamik të sistemit. Ky inxhinier ka kompetencat e nevojshme për të marrë vendime për zgjidhjet teknike dhe për të

mbajtur përgjegjësi profesionale, duke garantuar sigurinë, funksionalitetin e ndërhyrjeve që do të kryhen.

Specialistët e kërkuar janë vlerësuar të nevojshëm për arsye se:

Elektriçisti është i nevojshëm të kontrollojë dhe të mirëmbajë instalimet elektrike të ashensorit sipas standarteve të sigurisë, të identifikojë dhe rregullojë defektet në sistemin elektrik të tyre.

Duke qenë se ashensorët përbëhen nga agregate mekanike, Mekaniku është i nevojshëm për kontrollin dhe riparimin e këtyre agregatëve, sipas standarteve të sigurisë, në përputhje me certifikimet përkatëse të ashensorëve.

Punonjës i certifikuar për mirëmbajtje ashensorësh, është i nevojshëm për realizimin e kërkesave për mirëmbajtjen mujore të ashensorëve dhe FV vendosjen e pjesëve të defektuara, kërkesa të cilat duhet të realizohen nga punonjës të certifikuar, me qëllim sigurimin e AK që objekti i prokurimit do të realizohet në përputhje me standartet e sigurisë.

Duke qenë se ashensorët janë pajisje ngritëse që transportjnë njerëz dhe si të tilla bëjnë pjesë në kategorinë e pajisjeve me rrezik potencial për jetën dhe shëndetin, Ak ka përgjegjësi të sigurojë se shërbimi i mirëmbajtjes dhe furnizim vendosjes së pjesëve do të bëhet nga punonjës të kualifikuar për të ruajtur garancinë dhe sigurinë e pajisjeve, duke shmangur riskun për dëmtime, ndalime të shërbimit apo rrezikun për jetën dhe sigurinë e njerëzve.

AK ka përcaktuar që ofertuesi të disponojë stafin Teknik minimal të nevojshëm për realizimin e shërbimeve objekt prokurimi.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se Pajisjet/agregatet/materialet që do të përdoren për riparimin e difekteve të ashensorëve do të jenë të reja dhe sipas afateve të garancisë të dhëna nga prodhuesi ose nga distributorë të autorizuar nga prodhuesi.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Duke iu referuar specifikimeve teknike, duke qenë se objekti i prokurimit përfshin edhe furnizim vendosjen e agregateve/pajisjeve dhe pjesëve të këmbimit, me anë të kësaj deklarate synohet që mallrat që do të dorëzohen dhe vendosen të jenë të reja dhe me garanci nga prodhuesi ose nga distributorë të autorizuar nga prodhuesi. Nëpërmjet kësaj deklarate, synohet gjithashtu që fituesi i procedurës së prokurimit gjatë kësaj periudhe të garantojë për autoritetin kontraktor të përfshirë në këtë procedurë, që do të kryejë riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin pa pagesë konform specifikimeve teknike sa herë të lind nevoja.

2.3.5. Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se është i pajisur me çertifikatë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, dhe të jetë e vlefshme, si më poshtë:

S SH EN ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

S SH/EN/ ISO 45001 mbi “Sistemin e menaxhimit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalent;

Çertifikata duhet të jetë e lëshuar nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Standarti ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” – Ky standard është i nevojshëm pasi ndikon në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, duke qenë se ky standart fokusohet në cilësinë e procesit të riparimit të ashensorëve, rrjedhimisht siguron AK që ofertuesi do të përmbushë/realizojë shërbimet objekt prokurimi, sipas pritshmërive/specifikimeve teknike të kërkuara. Implementimi i këtij standarti mundëson menaxhim më efektiv të burimeve, rrit efikasitetin operacional dhe kontribuon në uljen e kostove dhe kohës së nevojshme për riparim.

Standarti ISO 45001 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” është vendosur si kriter me qëllim që AK të sigurohet që ofertuesi kryen shërbimin në përputhje me standartet e kërkuara sa i takon shëndetit dhe sigurisë në punë, si dhe me qëllim parandalimin/shmangien e çfarëdo rreziku, pasi shërbimet që do të kryhen përfshijnë ndërhyrje në ambiente të mbyllura (shkallë teknike, gropa teknike), punë pranë elementëve të lëvizshëm, ekspozim ndaj rreziqeve elektrike dhe mekanike. Pajisja e ofertuesit me këtë standart garanton AK se operatori ekonomik ka një sistem të dokumentuar për identifikimin e rreziqeve, marrjen e masave parandaluese dhe trajnimin e punonjësve për sigurinë, dhe rrit besueshmërinë e realizimit të kontratës/ave me përgjegjësi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike/afati i ekzekutimit, përlllogaritja e fondit limit janë përcjellë pranë OBP, të hartuara nga grupi i punës i caktuar nga titullari i autoritetit kontraktor “Spitali Rajonal Durrës”, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike/afati i ekzekutimit të hartuara nga grupi përkatës i punës, bazuar në nevojat e AK për llogari të së cilit po zhvillohet procedura e prokurimit, janë pjesë e pandarë e DST.

SPECIFIKIMET TEKNIKE.

LLOJI DHE NUMRI I ASHENSORËVE

Numri i ashensorëve: 7 copë

1. Ashensori i Sallave të Kirurgjisë;

Lloji: Ashensor Hidraulik Pasagjerësh (përdorim spitalor);
Numri i kateve që përshkohen: 2 ndalesa;
Nr. max i pasagjerëve: 15 persona;
Ngarkesa e lejuar: 1150 kg;
Prodhuesi : Samerlift;
Modeli/Tipi : CD 251;
Viti i prodhimit / instalimit: 2008;
Nr. Serial: a 01790;
Fuqia e motorit: 15 kW;
Shpejtësia e lëvizjes: 0.6 m/s.

2. Ashensori i Neurologjisë;

Lloji: Ashensor Hidraulik Pasagjerësh (përdorim spitalor);
Numri i kateve që përshkohen: 2 ndalesa;
Nr. max i pasagjerëve: 15 persona;
Ngarkesa e lejuar: 1150 kg;
Prodhuesi : GMV;
Modeli/Tipi : C 4;
Viti i prodhimit / instalimit: 2008;
Nr. Serial: CD 249 – 50/52;
Fuqia e motorit: 14.7 kW;
Shpejtësia e lëvizjes: 0.6 m/s.

3. Ashensori i vjetër i Patologjisë (Godina 4 katëshe);

Lloji: Ashensor Hidraulik Pasagjerësh (përdorim spitalor);
Numri i kateve që përshkohen: 4 ndalesa;
Nr. max i pasagjerëve: 20 persona;
Ngarkesa e lejuar: 1500 kg;
Prodhuesi : Doppler;
Viti i prodhimit / instalimit: 2008;
Nr. Serial: 15928;
Fuqia e motorit: 21 kW;
Shpejtësia e lëvizjes: 0.6 m/s.

4. Ashensori i ri i Patologjisë (Godina 4 katëshe);

Lloji: Ashensor Hidraulik Pasagjerësh (përdorim spitalor);
Numri i kateve që përshkohen: 4 ndalesa;
Nr. max i pasagjerëve: 20 persona;
Ngarkesa e lejuar: 1500 kg;
Prodhuesi: Has Elevator Turkey;
Instalues: Hymeri Kleman;
Viti i prodhimit / instalimit: 2020;
Nr. Serial: Kb_1234- IHR 6625 DURRESI HOSPITAL;
Shpejtësia e lëvizjes: 0.6 m/s.

5. Ashensori i Maternitetit;

Lloji: Ashensor Hidraulik Pasagjerësh (përdorim spitalor);

Numri i kateve që përshkohen: 4 ndalesa;

Nr. max i pasagjerëve: 16 persona;

Ngarkesa e lejuar: 1250 kg;

Instalues: DOPPLER - AL;

Viti i prodhimit / instalimit: 2008;

Nr. Serial: H 318;

Shpejtësia e lëvizjes: 0.6 m/s.

6. Ashensori i Pediatrikës (pranë Farmacisë);

Lloji : Ashensor Elektrik Pasagjerësh (përdorim spitalor);

Numri i kateve që përshkohen: 4 ndalesa;

Nr. max i pasagjerëve: 16 persona;

Ngarkesa e lejuar: 1250 kg;

Shpejtësia e lëvizjes: 0.6 m/s.

7. Ashensori i Pediatrikës (pranë Urgjencës);

Lloji: Ashensor Elektrik Pasagjerësh (përdorim spitalor);

Numri i kateve që përshkohen: 4 ndalesa;

Nr. max i pasagjerëve: 16 persona;

Ngarkesa e lejuar: 1250 kg;

Shpejtësia e lëvizjes: 0.6 m/s.

Shërbimet e kërkuara për çdo ashensor një herë në muaj për zërin mirëmbajtje periodike (parandaluese)

- Kontroll mujor sipas Udhëzimeve të Prodhuesit dhe legjislacionit në fuqi.
- Lubrifikimi i pjesëve lëvizëse.
- Kontrolli dhe rregullimi i sistemeve mekanike dhe elektrike.
- Testimi i sistemeve të sigurisë dhe sinjalizimit.
- Kontrolli i kabinës dhe dyerve të kateve për mbyllje/hapje korrekte.
- Pastrimi i fushave teknike dhe boshteve të ashensorit.
- Mbajtja e regjistrave të mirëmbajtjes.
- Disponueshmëri për ndërhyrje emergjente 24/7.
- Sinjalistikë dhe numri i kontaktit të teknikut të OE në rast emergjence brenda kabinës së ashensorit.
- Ndërhyrje brenda 12 orëve nga njoftimi i defektit.
- OE mban përgjegjësi për cilësinë e shërbimit dhe funksionimin e sigurt të ashensorëve.
- Pjesët e zëvendësuara duhet të jenë origjinale ose të aprovuara nga prodhuesi.
- Kontroll i kabllave mbajtëse dhe tensionit.
- Kontroll i makinës së ngritjes dhe sistemeve të kontrollit elektrik.
- Testim i sistemit të frenimit dhe ndalimit emergjent.
- Kontroll i inverterit UPS.
- Kontroll i pompës hidraulike dhe valvulave të drejtimit.
- Kontroll i nivelit dhe cilësisë së vajit hidraulik.
- Verifikim i cilindrave dhe tubacioneve për rrjedhje.
- Testim i presionit dhe përgjigjes së sistemit gjatë ngarkesës.

- Kontroll i panelit të komandimit dhe automatëve.
- Kontroll i lidhjeve elektrike dhe izolimit.
- Testim i sinjalizimeve dhe ndriçimit në kabinë dhe kate.
- Verifikim i butonave të thirrjes dhe komandave në kabinë.
- Kontroll dhe lubrifikim i udhëzuesve (shina rrëshqitëse).
- Kontroll i fiksimeve dhe sistemit të pezullimit.
- Kontroll i makinerisë dhe sistemit të frenimit.
- Kontroll i mbajtësve dhe boshtit të ashensorit për zhurma apo konsumim.
- Verifikimi i frerit parashutë (sistemi ndalues emergjent).
- Testimi i kufizuesit të shpejtësisë .
- Kontroll i ndalimit automatik në rast tejkalimi të katit.
- Kontroll i hapjes/mbylljes automatike të dyerve.
- Rregullim i motorëve të dyerve për lëvizje të qetë.
- Kontroll i sinjalizimit zanor dhe dritor në hapje.
- Inspektim i vijave të sigurisë dhe sensorëve anti-bllokim.
- Kontroll i ndriçimit të kabinës dhe kateve.
- Kontroll i indikatorëve të kateve (display).
- Ventilim dhe pastërti e ambientit teknik.
- Testim i funksionit të mbingarkesës.
- Verifikim i ndalimit të saktë në kat.
- Kontroll i lëvizjes vertikale dhe ndalimit pa dridhje.
- Testim i rikthimit në katin më të afërt në rast mungese energjie.
- Lubrifikim i komponentëve lëvizës (makineri, udhëzues, rrotulla).
- Pastrim i boshteve dhe kabinës nga pluhuri teknik.
- Plotësim i librit teknik të mirëmbajtjes (libri i ashensorit).
- Raport mujor mbi statusin teknik të ashensorit.
- Identifikim i nevojës për ndërrim pjesësh ose ndërhyrje të thelluar.

FREKUENCA E ZBATIMIT

Shërbime mujore (parandaluese): 1 herë në muaj për secilin ashensor.

Testim vjetor (i thelluar): 1 herë në vit sipas legjislacionit për sigurinë.

Ndërhyrje emergjente: Brenda 12 orëve nga njoftimi (ose 2-4 orë për raste kritike).

Shërbimet do të kryhen sipas kërkesës së Sektorit Teknik, çdo shërbim do të shoqërohet me proces-verbalin përkatës në prezencë të dy palëve (SRD-OE).

Në rast defekti OE do të njoftohet menjëherë nëpërmjet telefonit / e-mail-it dhe duhet ti përgjigjet kërkesës së AK menjëherë për zgjidhjen e defektit duke marrë në konsideratë rëndësinë e veçantë të institucionit të Spitalit Rajonal Durrës.

Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të mallrave objekt prokurimi, autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

NJËSIA E PROKURIMIT

